



DEMOCRACYPLUS

(PA)DREJTËSIA në prokurim

Raporti i Monitorimit
Tre Mujor të Organit
Shqyrtues të
Prokurimit

Dhjetor 2016 – Shkurt 2017



Prishtinë
Prill, 2017

(PA)DREJTËSIA në prokurim

OSHP është peshorja e tenderëve e cila vendos për fatin e miliona eurove në mosmarrëveshje në mes të institucioneve publike dhe sektorit privat

E drejta e autorit © 2017. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Raport i përgatitur nga:
Isuf Zejna dhe Sara Zhubi

Redaktuar nga:
Valmir Ismaili

Dizajni grafik nga:
Vladan Jaćimović

Përmbajtja

Pse OSHP?.....	4
Çka monitorohet?.....	5
Mbarëvajtja e seancave.....	5
Mungesa e rregullave të seancës.....	6
Shpenzimet e procedurës.....	7
OSHP si shkallë e dytë e ankesave.....	8
Konsistenca e vendimeve.....	9
Mungesa e dëshmitarëve në seanca.....	10
Transparenca.....	11
Transparenca e seancave.....	13
Publikimi i ankesave.....	14
Publikimi i Vendimeve.....	14
Mos-publikimi i raporteve të ekspertizës.....	15
Publikimi i njoftimeve për seanca.....	16
Ueb faqja e OSHP.....	17
Ekspertizat.....	18
Ekspertët shqyrtues.....	18
Ekspertët e jashtëm (teknik).....	19
Operatorët ekonomik.....	22
PBC.....	22
Ndërtimi.....	23
Security Code.....	23
Laguna.....	24
Botek.....	24
Autoritetet kontraktuese.....	25
Shkeljet e evidentuara në autoritetet kontraktuese.....	26
Institucionet më problematike.....	28
Lista e zezë.....	31
Niveli i angazhimit të anëtarëve të OSHP.....	32
Rekomandimet.....	33

Shkurtesat

AK	Autoriteti kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
D+	Demokraci Plus
DT	Dosje e tenderit
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MI	Ministria e Infrastrukturës
OE	Operatori ekonomik
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SIGMA	Përkrahja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Pse OSHP?

Prokurimi publik në Kosovë është një sektor i cili në të gjitha matjet dhe raportet konsiderohet si sektor me besim shumë të ulët të opinionit publik. Po ashtu, nëse analizohen raportet e institucioneve mbikëqyrëse si Zyra Kombëtare e Auditimit, auditorët e brendshëm, Agjencioni Kundër-Korrupsion dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, vërehet numër shumë i madh i shkeljeve të përsëritura në prokurimin publik. Prokuroria e Shtetit si institucion hetues gjithashtu i ka kushtuar një vëmendje më të madhe viteve të fundit korrupsionit në këtë sektor. Sidoqoftë, suksesi ka qenë simbolik në ndjekjen e zyrtarëve të lartë dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Ligjërisht OSHP është gardiani i të drejtave të operatorëve ekonomik përballë institucioneve publike në procedurat e prokurimit publik. Në mosmarrëveshjet rreth përzgjedhjes së kompanive fituese për aktivitetet e prokurimit, OSHP është institucion suprem administrativ i cili jep gjykimin përfundimtar nëse pretendimet ankimore janë të qëndrueshme. Vendimet e OSHP mund të sfidohen vetëm përmes gjykatës.

Për shkak të natyrës së punës, ky institucion konsiderohet me rrezikshmëri të lartë nga korrupsioni. Kjo për shkak se gjykon raste të cilat në fund përkthehen në fitime për bizneset dhe duke e pas parasysh kulturën lokale dhe mungesën e mbikëqyrjes efektive të këtij institucioni, ekziston mundësia që vendimmarrja të mos jetë çdo herë e pa-anshme.

Ish Kryetari i Bordit të OSHP Hysni Hoxha është shpall fajtor për një vendim të nxjerr në kuadër të punës së tij në këtë institucion¹. Për më tepër, kjo nuk ka qenë e vetmja aktakuzë e ngritur, pasi që bordi i këtij institucioni së bashku me një pjesë të ekspertëve shqyrtues kanë qenë cak i disa hetimeve të prokurorisë. Mediat kanë përmendur një numër prej të paktën tetë tenderësh të cilët kanë qenë cak i hetimeve të prokurorisë².

Dënimi i kryetarit të këtij institucioni, hetimet e shpeshta për vendimmarrjen e anëtarëve të OSHP dhe zërat e operatorëve të pakënaqur me punën e OSHP-së, kanë ndikuar në ulje serioze të besimit të publikut në këtë institucion. Madje, edhe në plotësim-ndryshimin e Ligjit të Prokurimit publik janë bërë disa ndryshime sa i përket punës së OSHP-së dhe formës se si trajtohen ankesat. OSHP me legjislacionin e ri është shkallë e dytë, pasi që fillimisht ankesat trajtohen nga vetë autoritetet kontraktuese.

1 Labinot Leposhtica, Dënohet Hysni Hoxha, Kallxo.com, 23-11-2016. Publikuar në: <http://bit.ly/2lhAQÄ>

2 Resmije Ballazhi, Hoxha nën hetime, Zeri.info, 12-10-2013. Publikuar në: <http://bit.ly/2m2zmqK>

Çka monitorohet?

Demokrasi Plus (D+) ka marr iniciativën e monitorimit të plotë të këtij institucioni për të vlerësuar paanshmërinë e OSHP-së në trajtimin e ankesave, transparencën, dhe integritetin e këtij organi. Qëllimi i monitorimit është që të identifikoj probleme konkrete dhe t'i përmirësoj ato përmes avokimit. Po ashtu, qëllim tjetër është edhe avokimi për rritjen e transparencës për shkeljet të cilat kryhen nga administrata shtetërore në dhënien e kontratave publike, përmes publikimit të shkeljeve në raportimet e D+.

Për këtë qëllim, D+ është prezent në të gjitha seancat e shqyrtimit ku lejohet pjesëmarrja e publikut. Po ashtu monitorohen vendimet e publikuara, ekspertizat, ankesat dhe të gjitha vendimet e tjera të cilat OSHP nxjerr.

Një ndër prioritetet e monitorimit të OSHP-së është krahasimi i standardeve të vendimeve, për të parë nëse vendimet paraprake të këtij institucioni respektohen si precedentë për vendimmarrje në rastet e ngjashme. Një vendim i OSHP-së i nxjerr për një rast paraprak do të duhej të shërbente si normë për gjykimin e rasteve të tjera, nëse faktet janë të përafërta. Kjo bëhet për të siguruar që operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese nxjerrin mësimet e duhura nga vendimet paraprake të OSHP-së që të mund të veprojnë në shmangien e ankesave dhe parregullsive në prokurim në të gjitha aktivitetet e radhës.

Vëmendje në monitorim i kushtohet edhe ekspertizave, duke e analizuar ndër të tjera cilësinë e ekspertizave bashkë me ekspertët e procedurave edhe ato për çështje teknike, si dhe në sa raste këto ekspertiza janë marr parasysh nga paneli dhe cila ka qenë performanca e ekspertëve të OSHP-së në përgjithësi.

Mbarëvajtja e seancave

Gjatë periudhës tre mujore, dhjetor 2016 – shkurt 2017, OSHP ka mbajtur gjithsej 105 seanca, me ç'rast janë shqyrtuar 119 ankesa. Nga këto ankesa, të trajtuara në seanca të hapura dhe me qasje të palëve të treta janë gjithsej 58, ndërsa 61 ankesa janë trajtuar në seanca të mbyllura, vetëm me përbërje të panelit dhe ekspertit të OSHP-së. Seancat e OSHP-së janë monitoruar në raste më të rralla edhe nga mediat, duke përfshirë Kohën Ditore dhe portalin Kallxo.com. Për më tepër, në një rast gazetarët nuk janë lejuar të xhirojnë brenda sallës së gjykit, fillimisht me arsyetimin se nuk ka hapësirë të mjaftueshme në sallë, e më pastaj me arsyetimin se kjo nuk lejohet në OSHP³.

3 Kallxo.com, OSHP nuk lejon kamerat në seancën për tenderin 9 milionësh, 27 Janar 2017. <http://bit.ly/2pXj6Mp>

Mungesa e rregullave të seancës

Gjatë monitorimit të seancave të OSHP-së, është vërejtur mungesë e rregullave të detajuara të përfaqësimit të palëve dhe strukturimit të seancave plenare. Në disa raste, palët lejohet të flasin pa fund dhe të paraqesin pretendimet ankimore, përderisa në seancat e tjera palëve iu është ndërprerë fjala dhe nuk u është dhënë e drejta të paraqesin të gjitha pretendimet e tyre. Është fakt i ditur se palët nuk mund të lejohen të flasin për kohë të pa arsyeshme, mirëpo OSHP duhet të adoptoj rregulla bazë të cilat zbatohen në formë të barabartë për të gjitha palët në procedurë. Kjo për shkak se nëse palëve u ndahet kohë jo e barabartë për të prezantuar, kjo do të thotë diskriminim në mundësinë për të bindur anëtarët e panelit.

Mundësi e mirë për OSHP-në do të ishte që varësisht nga vlera e kontratës, e vogël, e mesme, apo e madhe, t'i ndajë palëve nga 5, 10 apo 15 minuta për të prezantuar pretendimet ankimore para anëtarëve të panelit. Palët aty mund të rezervojnë nga një apo dy minuta nga koha e tyre për të komentuar apo kundërshtuar diskutimet fillestare të palës kundërshtare. Kjo do të mundësonte që OSHP dhe paneli të dëgjojnë në mënyrë të barabartë të gjitha palët.

Për më tepër në disa raste palët kanë ofenduar, fyer dhe kërcënuar njëri-tjetrin, apo anëtarët e panelit dhe nuk janë marr masa qoftë të dënimeve apo përjashtimeve nga seancat. Për shembull, në seancën e datës 22 janar 2017 ku është trajtuar ankesa e konsorciumit Krasniqi SHPK, Beni NTSH dhe Shafenberg GMBH, kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, seanca ka qenë e tensionuar, me fyerje dhe kërcënime nga palët. Përkundër kësaj, paneli i OSHP-së nuk ka marr asnjë masë kundër palëve të cilat nuk kanë respektuar rendin dhe parimet e respektit reciprok. Po ashtu, në seancën e 27 janarit 2017 ku është trajtuar ankesa e kompanive Çlirimi, Pevlaku dhe Alko-Impex kundër Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesi i kompanisë Alko-Impex Valon Ademi, gjatë gjithë kohës u ka ndërhyrë palëve të tjera në prezantimet e tyre. Asnjë masë nuk është ndërmarrë ndaj tij. Seancë tjetër me probleme është evidentuar në rastin e ankesës së Kompanisë El-Bau kundër Komunës së Vitisë, ku Drejtori i Prokurimit Fadil Abazi e ka fyer dhe i ka ndërhyrë përfaqësuesin e Kompanisë El-Bau gjatë prezantimit të pretendimeve ankimore.

Udhëheqësi i panelit në seancën dëgjimore duhet të sigurohet që palët respektojnë institucionin dhe palët e tjera, dhe në rast të shkeljeve merren masa kundër tyre. Masat kundër palëve mund të përfshijnë përjashtimin nga seanca, dënimet në të holla apo edhe masa të tjera të përshtatshme për të disiplinuar pjesëmarrësit në seancat dëgjimore. Kjo duhet të bëhet duke adoptuar praktikën e gjykatave të rregullta, arbitrazheve apo edhe institucioneve të tjera të ngjashme me OSHP-në.

Shpenzimet e procedurës

Buxheti i OSHP-së për vitin 2016 ka qenë 329,883 euro. Nga ky buxhet, pjesa më e madhe shpenzohet në paga dhe mëditje, gjegjësisht 210,428 euro për 23 të punësuar. Në anën tjetër, 114,355 euro janë shpenzuar për mallra dhe shërbime. Të gjitha shpenzimet e OSHP mbulohen nga ndarja e buxhetit nga Kuvendi. Përkundër faktit që OSHP është një organ i cili edhe aktualisht gjeneron të hyra, mirëpo i cili ka mundësi të bëjë më tepër po që se do të respektonte plotësisht Ligjin e Prokurimit dhe Rregulloren e Punës. Kjo do të bëhej duke i kërkuar palëve që humbin kontestet të bëjnë mbulimin e shpenzimeve të procedurës.

Aktualisht të vetmet të hyra për OSHP-në janë gjobat për institucionet të cilat nuk i respektojnë vendimet e këtij institucioni dhe depozitat e ankesave për bizneset të cilave u hedhen ankesat si të pabazuara. Sidoqoftë, operatorëve ekonomik në të shumtën e rasteve ankesat u shpallen ose të palejuara ose pjesërisht të bazuara dhe në të dyja këto raste ato kanë të drejtë ta kthejnë mbrapa depozitën e tyre. Madje është vërejtur që edhe pse bizneset nuk arrijnë të provojnë pretendimin e tyre ankimor, prapë se prapë OSHP u kthen depozitën. Mirëpo, palët duhet të paguajnë për ankesat e tyre, ngjashëm me gjykatat e rregullta, institucionet e arbitrazhit apo edhe ato administrative. Pala e cila e humb kontestin duhet t'i mbulojë shpenzimet e procedurës.

Një mënyrë e mirë për të shmangur ankesat e pabaza, të cilat kanë për qëllim vetëm të përdorin OSHP-në si mundësi për të provuar shansin e fundit për të ndikuar në aktivitet të prokurimit, do të ishte edhe aplikimi i dënimit dhe ndalesat në depozita. Kështu për shembull, nëse kompania nuk mund të vërtetojë asnjë nga pretendimet, apo nuk arrijnë të arsyetojë pretendimet kyçe të ankesës, asaj në asnjë rast nuk duhet t'i kthehet depoziti. Nëse kompania arrin të vërtetojë një numër të pjesshëm të pretendimeve, atëherë depoziti duhet t'i kthehet pjesërisht. Në rastet kur ankesat janë bërë mbi bazën e pretendimeve qartë të paqëndrueshme dhe nuk përkojnë me të vërtetën në asnjë formë, atëherë në përputhje me Ligjin, operatorët ekonomik duhet të dënohen. Konfiskimi i pjesshëm i depozitës aktualisht nuk është i paraparë në Ligj apo Rregullore të OSHP-së, sidoqoftë është një nga praktikatat e mira që përdoret në disa vende për të shmangur ngarkesat e panevojshme të institucionit.


Në përgjigjen e OSHP-së në lidhje me të gjeturat e këtij raporti, thuhet se OSHP nuk ka mandat ligjor për të dënuar operatorët ekonomik të cilët parashtrojnë ankesa të paqëndrueshme. Përkundrazi OSHP thotë se është në mandatin e tyre ta trajtojë deri në fazën e fundit çdo ankesë. Mirëpo Ligji i Prokurimit Publik ka përcaktuar të drejtën e këtij institucioni që të dënoj operatorët të cilët paraqesin

pretendime të pabazuara me 5000 euro gjobë⁴. Rëndësia e ndëshkimit të ankesave qartësisht të pabazuara është shkarkimi i punës së OSHP-së dhe shmangia e ankesave të cilat nuk kanë pretendime serioze ankimore, por vetëm paraqiten për të vonuar procedurat e prokurimit. Madje në shumë raste, kompanitë paraqesin sa më shumë pretendime vetëm për të bërë ankesën e tyre më bindëse, dhe kjo e ngarkon punën e institucionit, duke përfshirë referuesin e lëndës, panelin dhe ekspertët shqyrtues. Për këtë arsye, kompanitë duhet të mbahen përgjegjëse për secilin pretendim ankimor veç e veç.

OSHP si shkallë e dytë e ankesave

Me ndryshimet e Ligjit të Prokurimit Publik të vitit 2016, OSHP nuk është shkallë e vetme e ankesës. Ligji ka paraparë që në fazë fillestare, ankesat të dërgohen në vetë autoritetin kontraktues, përkatësisht institucionin i cili ka udhëhequr me aktivitetin e prokurimit publik. Kjo ka ndikuar që autoritetet kontraktuese të kenë një mundësi shtesë për të përmirësuar gabimet eventuale.

ANKESAT NË TRI VITET E FUNDIT



Në këtë tabelë paraqitet numri i ankesave që bizneset kanë paraqitur në OSHP për tri vitet e fundit. Ndryshimi i Ligjit të Prokurimit Publik ka ndikuar që institucionet të trajtojnë ankesat para se ato të dërgohen në OSHP. Kjo ka bërë që numri i ankesave të zvogëlohet ndjeshëm nga vitet paraprake.

Megjithëse, nuk dihet numri i saktë i ankesave të shkallës së parë në të gjitha autoritetet kontraktuese, OSHP ka pranuar 111 ankesa më pak sesa në vitin paraprak. Kjo paraqet progres mjaftë të qëndrueshëm në raport me ngarkesën e punës së OSHP-së, pasi që sa më pak ankesa që ka bordi i këtij institucioni, mund t'i kushtohet më shumë kohë dhe vëmendje çështjeve të cilat janë të me të vërtetë të rëndësishme. Shumë vendime të OSHP-së nuk janë vetëm të rëndësishme për lëndën përkatëse, por edhe për precedentin që ato krijojnë. Për shembull, nëse ky institucion në një vendim thotë se aktiviteti i prokurimit nuk mund të anulohet pasi të ketë përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave, atëherë diçka e tillë do të ishte një standard i vendosur që do të vrente edhe për të gjitha rastet e ardhshme. Kjo do të thotë se vendimet e OSHP mund të ndikojnë në sjelljet e ardhshme të operatorëve dhe autoriteteve kontraktuese, si pasojë e vendimeve të marra në të kaluarën.

Konsistenca e vendimeve

Numri i madh i ankesave ndikon që panelet shqyrtuese të kenë më pak kohë për të shqyrtuar në detaje rastet e ankesave. Në shumë raste, trajtimi i ankesave kërkon hulumtime profesionale dhe kontrollim të dyfishtë të ekspertizës, pasi që palët ankuese shpesh herë kanë ankesa shumë serioze kundër ekspertizave. Nëse gjatë një viti OSHP trajton 592 ankesa, siç është rasti në vitin 2015, dhe një anëtar i panelit merr pjesë në shqyrtimin e 400 ankesave dhe kjo pjesëtohet me 220⁵ ditë pune brenda vitit kalendarik, atëherë i bie që një anëtar i panelit mund t'i kushtojë kohë pak më shumë se gjysmë dite shqyrtimit të një rasti në prokurim.

Ky volum i madh i rasteve, së bashku me mungesën e konsistencës së vendimeve nga rasti në rast, rrezikojnë që shqyrtimi i rasteve të jetë sipërfaqësor dhe të mos ketë hulumtim dhe shqyrtim të mirë të rasteve. Deri më tani, edhe pse është e lejuar me Ligj dhe Rregullore të Punës së OSHP-së, ky institucion nuk ka vendosur praktika të unifikimit të standardeve të vendimeve. Blerim Dina, kryetar i këtij institucioni thotë se kjo nuk është e mundur të bëhet pasi që secili rast dallon nga rasti tjetër për nga faktet dhe rrethanat, andaj nuk mund të trajtohen si raste të unifikuara⁶. Sidoqoftë, vendosja e standardeve në çështje të caktuara është praktikë e mirë juridike, përmes të cilave institucionet të cilat ndajnë drejtësi vendosin disa rregulla bazë të cilat mund të përdoren si precedentë në gjykimet e ardhshme. Të tilla mund të jenë gjykimi i çmimeve jo-normalisht të ulëta në sektorin e sigurimi të objekteve, çështjet e kontratave të shërbimeve të hotelerisë dhe çështje specifike të kontratave të shërbimeve të pastrimit.

⁵ Në këtë numër janë hequr nga llogaria ditët e pushimeve të festive zyrtare, vikendet dhe pushimet vjetore sipas ligjit
⁶ Blerim Dina, intervistë personale (24.03.2017).

Krijimi i disa standardeve të vendimmarrjes, ku një sërë faktesh kryesore janë të njëjta apo të ngjashme në masë të konsiderueshme, do të ndihmonte këtë institucion në unifikimin e vendimmarrjes. Si e tillë, OSHP do të rriste besimin e operatorëve ekonomik dhe publikut në përgjithësi. Në disa raste operatorët citojnë vendimet paraprake të OSHP-së në ankesat e tyre në lidhje me rastet të cilat konsiderohen precedent, mirëpo kjo duket të mos iu ketë ndihmuar shumë.

Në mungesën e rasteve të unifikuara duket se ndikon edhe vet përpilimi i vendimeve. Në të shumtën e rasteve, vendimet janë të mbushura me fakte të rastit dhe informata për aktivitetin e prokurimit. Më tutje aty sqarohen ekspertiza dhe qëndrimet e palëve nëse e kanë pranuar apo jo këtë ekspertizë, mirëpo shumë më pak sqarohet thelbi i problemit dhe arsyet të cilat e kanë drejtuar panelin shqyrtues drejt vendimmarrjes së caktuar. Për shembull, në seancën e datës 15 mars 2017 në të cilën janë trajtuar rasti *Pastro-Kosova, Professional-Alarm v. Korporata Energjetike e Kosovës*, 45/17. gjatë gjithë seancës në asnjë rast nuk janë përmendur specifikisht pajisjet jo të përshtatshme të cilat sipas KEK nuk i kanë plotësuar kushtet. Gjithçka është trajtuar në terme abstrakte, duke u referuar në terma të përgjithshëm pa e specifikuar cili produkt me cilin numër. Në këtë rast, edhe pse katalogjet e prodhuesit kanë qenë të qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe nga prodhuesi, anëtarët e panelit dhe eksperti në asnjë rast nuk e kanë ngritur këtë çështje.

Mungesa e dëshmitarëve në seanca

Përkundër që thirrja e dëshmitarëve dhe personave që mund të ofrojnë informacione të rëndësishme për këtë institucion është e mundur, OSHP në asnjë rast gjatë periudhës raportuese nuk e ka ftuar asnjë person për të raportuar. Në raste të izoluara është vërejtur se OSHP u kërkon informacione me shkrim institucioneve apo personave të cilët ka nevojë, mirëpo që shumë shpesh të dhënat e operatorëve dhe autoriteteve kontraktuese për të njëjtën çështje janë diametralisht të kundërta. Për shembull, *Reforma v. Policia e Kosovës*, 429/16. palët nuk janë pajtuar nëse kompania e cila i ka ofruar pajisje për servisim të automjeteve ka apo nuk ka referencën e prodhuesit për shitjen e pjesëve. Kjo çështje mund të verifikohet nëse OSHP do të ftonte përfaqësuesin e prodhuesit në Kosovë për të dëshmuar për referencën e kërkuar. Për më tepër, dëshmia pranë OSHP-së do t'i ofronte rastin anëtarëve të panelit dhe palëve në mosmarrëveshje që të shtrojnë pyetje për dëshmitarin për të sqaruar të gjitha rrethanat. Në këtë rast, kompania e cila ka ofruar autorizim me shkrim të prodhuesit është shpallur e pa përgjegjshme, pasi që Policia ka thënë se ka marr sqarime nga përfaqësuesi i kompanisë në Kosovë se më tutje nuk e mbështesin këtë kompani për të aplikuar në procedurën

e përsëritur të tenderit. Tërheqja e autorizimit në mënyrë të njëanshme do të duhej të ishte një ndër çështjet që sqarohet në procedurë, pasi që kjo e ka ngritur koston e projektit për rreth 600.000 euro. Në raste të tilla, është në interesin publik që OSHP të marr të gjitha masat për të vërtetuar se veprimet e kompanisë e cila ka autorizuar operatorin ekonomik për të ofertuar dhe veprimet e Policisë së Kosovës janë në përputhje me Ligjin.

Të tilla raste, ku mosmarrëveshjet janë diametralisht të kundërta, madje edhe dëshmitë materiale siç është rasti me referenca apo dokumente të tjera, është shumë e rëndësishme që në të gjitha rastet ku është e mundur, të dëshmojnë përfaqësuesit e institucioneve apo personat privat që kanë informacione. Sipas kryetarit të OSHP Blerim Dina, institucioni që ai drejton, si metodologji preferon më shumë komunikimin nëpërmjet shkresave me dëshmitarët dhe palët e treta⁷. Kjo edhe mund të jetë një ndër format e punës, mirëpo vetëm për rastet ku pjesëmarrja e dëshmitarëve nuk është e mundur. Në të gjitha rastet ku dëshmitarët mund të sigurohen për seancë, kjo duhet të aplikohet si praktikë para se të merren vendimet. Në mungesë të dëshmitarëve në seancë, paneli shërbehet me pyetjet të cilat janë drejtuar nga referuesi i lëndës apo eksperti, e të cilat mund të mos jenë të plota apo të adresojnë thelbin e ankesave.

Transparenca

Mungesa më serioze e identifikuar në punën e OSHP-së është transparenca. Kjo madje në shumë dimensionë të punës së këtij institucioni, të cilat kur mbledhen së bashku japin një indeks të ulët të llogaridhënies për publikun. Për shembull, OSHP në shumicën e seancave rreth 60% në periudhën raportuese ka mbajtur seanca pa publikun. Të gjitha mbledhjet përveç seancave dëgjimore janë mbajtur pa praninë e publikut dhe të palëve në kontest. Si të tilla këto takime janë publike vetëm në pjesën ku palët prezantojnë pretendimet, përderisa mbyllen më pas përgjatë fazës së shqyrtimit të fakteve, provave dhe vendimmarrjes. Për më tepër, përveç vendimeve nuk publikohen procesverbalet e këtyre mbledhjeve, diskutimet e anëtarëve, provat të cilat janë peshuar në seancë dhe përfundimisht votimi i anëtarëve. Për më keq, as numri i votave në favor apo kundër vendimit nuk është publik.

Në lidhje me çështjet të cilat ky raport i ka evidentuar si mungesë e transparencës OSHP arsyeton se janë respektuar Ligji dhe rregulloret në fuqi, të cilat kanë përcaktuar se mbajtja e seancave nuk duhet të jetë publike. Përgjashtimisht publike janë takimet me palët ku prezantohen pikat e ankesës dhe mbrojtja nga autoriteti kontraktues. Në anën tjetër dokumentet e tjera janë të qasshme sipas kërkesave që vijnë nga palët në kuadër të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Për më tepër OSHP sqaron se

⁷ Blerim Dina, intervistë personale (24.03.2015).

“çdo trup gjykues në çdo gjykatë të Kosovës e ka të mbyllur seancën për këshillim dhe votim, dhe nuk e bën publike votën e trupit gjykues, por vetëm vendimin përfundimtar. Një gjë të tillë e bëjmë dhe ne si panel shqyrtues”⁸. Ndërsa në lidhje takimet e këtij institucioni pa prezencën e publikut OSHP konsideron se “sa i përket mbledhjeve të mbyllura, OSHP si organ i pavarur për shqyrtim administrativ, me LPP e ka të rregulluar çështjen e konfidencialitetit nga përhapja në publik ose persona të paaautorizuar, informacionet. Në të gjitha rastet (Mbledhjet) kur diskutohen çështje të brendshme për mbarëvajtjen e institucionit, analizimi dhe shqyrtimi i rasteve, dhe seancat për këshillim dhe votim, janë të mbyllura për palët, dhe ashtu siç e kemi cekur këtë e kemi të lejuar me ligj, mirëpo shqyrtimi i fakteve dhe provave në të gjitha seancat e hapura bëhet gjatë seancës dëgjimore, ku secila palë prezanton fakte dhe në një formë ato fakte vetëm shqyrtohen aty për aty nga anëtarët e panelit shqyrtues”.

Në raportin vjetor të punës, i cili është i publikuar në ueb faqen e OSHP, pjesa e buxhetit të OSHP nuk është përfshirë. Kjo vlen të thuhet se ka ndodhur për herë të parë që financat e këtij institucioni të mos publikohen në raport vjetor të punës. Në vitet e kaluara që nga ekzistenca e këtij institucioni këto financa kanë qenë publike, të paktën në terme të përgjithshme. OSHP në lidhje me mungesën e të dhënave financiare në raportin vjetor sqaron “Raporti financiar vjetor i OSHP-së është i një forme standarde të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe pasi që i njëjti shkruhet në një formular standard të mbrojtur të Kuvendit, nuk ka mundur të përshkruhet në raport vjetor, mirëpo i njëjti vetëm i është bashkangjitur si shtojcë raportit vjetor”⁹.

Në çështjet e transparencës, OSHP shpesh herë arsyetohet se kjo bëhet për të mos rrezikuar integritetin e procesit të marrjes së vendimeve dhe për të ulur çdo presion mbi anëtarët e OSHP-së. Ky argument deri diku mund të jetë edhe i qëndrueshëm për arsye se anëtarët e OSHP mund të jenë objekt i hetimit, kërcënimeve nga bizneset apo edhe vet autoritetet kontraktuese. Sidoqoftë, kjo nuk arsyeton mjaftueshëm gjithë mungesën e transparencës në këtë institucion. Publiku ka të drejtë të dijë se si merren vendimet në lidhje me ankesat për prokurimin publik. Ky është kusht minimal i llogaridhënies së anëtarëve të OSHP-së të cilët zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës. Si të tillë, ata i obligohen publikut të Kosovës ashtu sikurse edhe institucioni i cili i ka zgjedhur ata, që të japin llogari në lidhje me vendimet të cilat i kanë marrë. Kjo më tepër do t'i shërbente edhe monitorimit të konfliktit eventual të interesit, anshmërisë potenciale të anëtarëve të OSHP-së dhe të tjera çështjeve me rëndësi për integritetin e këtij institucioni. Kur mos transparencës në vendimmarrje i shtohet fakti se arsyetimet e vendimeve janë shumë varfër dhe shkarazi të arsyetuara, mund të vijmë në përfundimin se OSHP nuk arrin standardet e duhura të transparencës.

8 Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

9 Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

Transparenca e seancave

Seancat e OSHP janë vetëm pjesërisht të hapura. Mediat, OJQ-të dhe publiku mund të kenë qasje vetëm në pjesën e prezantimit të pretendimeve ankimore të palëve, çdo fazë tjetër e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit është e mbyllur. Kjo madje nuk mund të shihet as me dokumente si procesverbalet apo vendimet e takimeve, pasi që aty përveç vendimit që ka marrë institucioni nuk ka kurrfarë të dhëna në lidhje me debatin, çështjet e argumentuara, kundërshtimet apo të tjera informata relevante. Video dhe audio incizimet e seancave të cilat konsiderohen të hapura nuk lejohen nga ana e anëtarëve të OSHP-së. Në lidhje me këto vërejtje të identifikuara nga D+ në kuadër të monitorimit OSHP ka thënë se “të gjitha seancat që janë publike, mediat mund të jenë pjesëmarrëse. Po ashtu, sa i përket fazës së vendimmarrjes, përpos votës që nuk është publike, vendimi përfundimtar është publik për secilin medium. Nëse dikush nga mediat mund të jetë i interesuar për të gjithë procedurën e shqyrtimit të një ankesë, që nga fillimi e deri në vendimin përfundimtar, atëherë me një kërkesë për qasje në dokumente publike, mund të i marrë të gjitha të dhënat. Rastet kur një OJQ apo një medium kanë qenë të interesuar të marrë më shumë të dhëna se ato që janë të publikuara, janë shumë të shpeshta, dhe këtë mund ta verifikoni në arkivën e OSHP-së (shih rastin e KDI-së në arkivën e OSHP-së, ku OJQ-ja në fjalë me një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare ka marrur të gjitha ankesat, raportet e ekspertizave dhe vendimet e OSHP-së për AK - Ministria e Infrastrukturës)”¹⁰.

Në këtë periudhë raportuese janë shqyrtuar 119 ankesa të operatorëve ekonomik në gjithsej 105 seanca të shqyrtimit. Nga këto ankesa, 61 janë shqyrtuar në seanca të mbyllura dhe pa praninë e palëve të cilat kanë parashtruar ankesat.

Arsye për mbajtjen e seancave pa palë dhe pa publikun sipas Kryetarit të OSHP-së është rekomandimet që OSHP merr nga SIGMA/OECD projekti në Kosovë, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian. Sipas tyre kjo ndikon në rritjen e efikasitetit të institucionit¹¹. Mirëpo, përkundër këtij arsytimi OSHP ka problem më të madh vet integritetin institucional dhe mungesë e transparencës vetëm sa mund ta keqësojë këtë besim të publikut, institucioneve dhe sektorit privat.

10 Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

11 Blerim Dina, intervistë personale (24.03.2015).

Publikimi i ankesave

Sipas Rregullores së Punës, OSHP është e obliguar të bëjë publikimin e ankesave të operatorëve ekonomik. Kjo pjesë në masë të madhe zbatohet dhe një numër i madh i ankesave janë të qasshme përmes ueb faqes. Përkundër që këto dokumente janë publike sipas rregullores së punës, në shumë raste ato nuk janë të plota dhe për më tepër janë të paorganizuara. Edhe pse ueb faqja ka pjesën e kushtuar posaçërisht ankesave, aty nuk mund të gjenden të gjitha ankesat e dorëzuara nga operatorët ekonomik.

Pjesa e ankesave të vitit 2016 janë, po ashtu, të vendosura tek vendimet, si dhe nuk janë të emëruara në atë formë që të gjenden sipas datës, operatorit apo autoritetit kontraktues. Edhe pse këto ankesa janë publike, ato nuk janë të plota dhe nuk janë të rregulluara në atë formë që të gjenden lehtësisht në ueb faqe. Emërtimi, palët dhe të dhënat bazë të kontratës nuk janë të rregulluara në atë formë që të shërbejnë si filtër të kërkimit për shfletuesit e faqes së OSHP.

Shembull ilustrues të mos publikimit të plotë të ankesave të operatorëve ekonomik janë: *IPKO v. Ministria e Administratës Publike*, 448/16. *Çlirimi v. Ministria e Shëndetësisë*, 443/16. *Alta, Elcom v. Korporata Energetike e Kosovës*, 459/16. Këto ankesa ashtu sikurse edhe shumica absolute e ankesave të tjera, nuk janë të skanuara dhe të qasshme tërësisht. Në këto tri raste, nuk mund të kuptohet asgjë në lidhje me përmbajtjen e ankesave. Ankesa e konsorciumit Alta dhe Elcom për më tepër e ka të publikuar vetëm faqen e parë të formularit, ku janë të vendosura vetëm të dhënat e përgjithshme të ankesës dhe për më shumë skenimi është aq i dobët sa leximi është pothuajse i pamundur.

Publikimi i vendimeve

Publikimi i vendimeve është po ashtu një kërkesë ligjore dhe OSHP është e obliguar ta bëjë këtë pesë ditë pasi të jetë marr vendimi nga paneli shqyrtues. Vendimi përveç se i dërgohet palëve, OSHP duhet edhe t'i bëjë publik në ueb-faqen zyrtare. Një nga problemet e identifikuar në këtë rast është mos publikimi i vendimit brenda afateve ligjore. Kjo shkelje pothuajse është e përsëritshme në OSHP, pasi që pjesa më e madhe e vendimeve publikohen me vonesë, disa prej tyre madje me vonesë të tepruar. Vonesat në publikimin e vendimeve variojnë nga një ditë deri në 67, siç është rasti me publikimin e vendimit për rastin: *Interadria, InterAdria v. Policia e Kosovës*, 331/16. Vonesa e publikimit të vendimeve paraqet pengesë për autoritetet kontraktuese pasi që bënë vonesa në zbatimin e projekteve të prokurimit, gjë e cila mund të ndikojë aftësinë e institucioneve për t'i shërbyer qytetarëve. Sipas Kryetarit të OSHP këto

vonesa ndodhin si pasojë e mbingarkesës me lëndë të administratës, e cila bën shkrimin e vendimeve¹². Sidoqoftë, kjo nuk mund të jetë krejt e arsyeshme pasi që disa vendime publikohen brenda ditës në të cilën është marr vendimi. Shikuar nga këndi i rrezikshmërisë, vonesa në publikimin e vendimeve mund të konsiderohet si mjet për t'i bërë presion kompanisë apo institucionit. Megjithëse kjo nuk është e thënë të jetë arsye në këtë rast, prapë se prapë OSHP duhet të mbyllë të gjitha pikat të cilat mund të ngjallin dyshime apo shtojnë rrezikun për korrupsion.

Mos-publikimi i raporteve të ekspertizës

Në numrin më të madh të rasteve, ekspertiza përcakton fatin e ankesës. Një numër i operatorëve ekonomik madje shkojnë edhe më larg duke tërhequr ankesat e tyre nëse ekspertiza nuk është në favor të pretendimit të tyre ankimor. Mirëpo edhe përkundër që ka një rëndësi shumë të madhe, ky dokument nuk publikohet në ueb faqen e OSHP-së. Krejt çka është publike, është rekomandimi i ekspertit, nëse ai rekomandon që të aprovohet ankesa apo të hedhet poshtë. Arsyet të cilat e kanë qar ekspertin të rekomandoj këtë, nuk janë publike dhe analiza e bërë nga eksperti nuk përfshihet plotësisht në vendimin e panelit. Kjo zakonisht përfshinë një pjesë të shkurtër të diskutimit të përmbledhur nga ana e ekspertit gjë që publikohet në vendim. OSHP në lidhje me mos publikimin e ekspertizave arsyeton se “për shkak të ekonomizimit të procedurës, mund të këtë ndodhur që të mos përfshihen të gjitha konstatimet e ekspertit shqyrtues në ndonjë vendim të PSH-së, mirëpo ju mund të hyni dhe verifikoni edhe shumë raste tjera ku të gjitha konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të përfshira në vendim”¹³.

Sidoqoftë, në rastet kur monitoruesit duan të vlerësojnë pa anshmërinë e ekspertit apo vet kualitetin e ekspertizës e cila në të shumtën e rasteve e ndikon vendimin e OSHP-së, kjo është e pamundur të bëhet me dokumentet e ofruar si të qasshme. Andaj publikimi i raporteve të ekspertëve do të ndihmonte në mënyrë të ndjeshme në rritjen e transparencës së këtij institucioni.

Gjatë kësaj periudhe raportuese në të cilën janë shqyrtuar 119 ankesa, vetëm në tetë raste nuk janë angazhuar ekspertë. Kjo pasi që ankesat janë kthyer si të palejueshme për mos përmbushje të kushteve ligjore për shqyrtim. Nga 111 raste të ankesave ku janë angazhuar ekspertë, në vetëm 31 raste vendimi i panelit ka qenë në kundërshtim me rekomandimin e ekspertit. Kjo paraqet një efikasitet mjaft të lartë të ekspertizave, me mbi 70% të ndikimit në vendime. Ekspertiza pra paraqet në masën më të madhe arsyetimin kryesor të paneleve shqyrtuese në shqyrtimin e ankesave.

¹² Blerim Dina, intervistë personale (24.03.2017).

¹³ Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

Publikimi i njoftimeve për seanca

Në parim të gjitha seancat e OSHP të cilat mbahen me palët, janë publike për t'i monitoruar. Përkundër që OSHP bënë publike njoftimet për seancë në ueb faqe, gjatë kësaj periudhe raportuese janë evidentuar shtatë seanca të cilat nuk janë publikuar në kuadër të njoftimit për mbajtje të seancës. Arsyetimi i OSHP është se kjo është bërë për fajin e personit i cili kryen punët e teknologjisë informative në OSHP. Sidoqoftë, përgjegjësia për mos publikim të njoftimeve për mbajtjen e seancës i përket institucionit dhe ajo nuk mund t'i hidhet një individi.

Mbajtja e seancave të OSHP-së publikohet në ueb faqe nga një javë e deri në një ditë para seancës. Në të shumtën e rasteve seancat paralajmërohen dy ditë para mbajtjes. Gjatë monitorimit kemi vërejtur raste kur seancat janë publikuar edhe vetëm një ditë para mbajtjes së takimit. Ky afat i shkurtër nuk u jep palëve kohë të mjaftueshme për të përgatitur përfaqësimin para panelit dhe përballjes me ekspertin dhe palët kundërshtarë. Po ashtu, njoftimi për seancë është shumë i mangët pasi që publikon të dhëna shumë të kufizuara në lidhje me seancën. Në këtë njoftim publikohen vetëm emrat e palëve dhe numri i ankesës. Gjatë monitorimit është vërejtur se në disa raste për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe ankesave që kanë pasur në OSHP, disa institucione dhe biznese nuk kanë qenë në gjendje të dinë arsyen e as materien e ankesës. Kjo në mënyrë serioze e kufizon mundësinë për të mbrojtur pretendimet e institucioneve që përfaqësojnë. Në lidhje me këtë çështje OSHP sqaron "të dhëna tjera nuk kanë nevojë që të publikohen. Të gjitha palët si autoritetet kontraktuese, sikurse OE ankues dhe ata të rekomanduar për kontratë, përmes emrit, dhe numrit të lëndës mund të jenë të njoftuar për seancë"¹⁴. Për më tepër OSHP në komentet për këtë raport është shprehur e gatshme që të rrisë informacionet e publikuara në njoftime për seancë duke shtuar edhe emrin e aktivitetit të prokurimit.

Në disa raste, seancat dëgjimore të OSHP-së kanë dështuar të mbahen. Për këtë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm të tillë si njoftimet për palët nuk janë dërguar, palët nuk kanë ardhur në seancë, kanë munguar ekspertët apo kanë munguar anëtarët e panelit. Të gjitha seancat që janë shtyrë për afat të pacaktuar nuk janë lajmëruar më në ueb faqe për kohën kur do të mbahen. Megjithëse, këto seanca janë mbajtur, vetëm palët janë ftuar të marrin pjesë dhe nuk ka pasur më tutje njoftim në ueb faqe.

Menaxhmenti i OSHP duhet të sigurohet që seancat dëgjimore të organizohen në formë që i japin kohë të mjaftueshme të gjitha palëve që të përgatisin mbrojtjen dhe dëshmitë e tyre. Po ashtu, menaxhmenti duhet të sigurohet se njoftimet për mbajtjen e seancave përfshijnë edhe seancat të cilat janë shtyrë apo nuk janë mbajtur në afatin e paraparë vendosen në ueb faqe.

¹⁴ Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

Ueb faqja e OSHP

Komunikimi i parë dhe më i rëndësishëm i OSHP me publikun dhe palët është përmes ueb faqes së institucionit. Për këtë arsye një ueb faqe funksionale dhe e strukturuar me informatat e nevojshme për palët dhe publikun është esenciale për transparencën e institucionit.

OSHP ka funksionale ueb faqen e saj, e cila siguron një numër të madh të informatave për të gjithë të interesuarit. Përkundër faktit që kjo ueb faqe ekziston, ka disa probleme për qasje në informacione, kryesisht për shkak të problemeve teknike të cilat në shumë raste e pamundësojnë qasjen e përdoruesve. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve është identifikuar se ueb faqja e OSHP ka qenë jashtë funksionit dhe për këtë arsye ka qenë e pamundur qasja në informata.

Për të testuar sistemin kemi krahasuar ueb faqen e OSHP-së me ueb faqet e tjera të serverit qeveritar dhe ka rezultuar se në të gjitha këto raste, problemi ka qenë vetëm me ueb faqen e OSHP-së. Ueb faqet e tjera kanë qenë të qasshme dhe kanë funksionuar pa probleme. Në lidhje me ueb faqen OSHP sqaron "OSHP ju sqaron se ueb-faqja është në procedurë të prokurimit në AQP, të ridizajnit dhe ri-organizimit të saj. Procedura ka filluar në gjysmën e dytë të vitit 2016, dhe akoma është duke vazhduar. Për këtë arsye mund të këtë edhe pengesa siç ju i keni cekur dhe mos organizim të mirëfilltë. Kemi të bëjmë me një teknologji dhe dizajn të vjetër dhe një gjë e tillë pritët të rregullohet së shpejti"¹⁵.

Problem tjetër i identifikuar në këtë ueb faqe është organizimi, emërimi dhe postimi i dokumenteve. Janë shumë të shpeshta rastet kur ankesat postohen tek vendimet. Po ashtu, kërkimet për dokumente më të vjetra sesa viti aktual, është i pamundur për disa kategori, siç janë vendimet e gjykatave, konkluzionet dhe njoftimet. Njoftimet për mbajtjen e seancave fshihen për t'i postuar njoftimet e reja. Arkivimi i këtyre njoftimeve është me rëndësi të mbetët i qasshëm.

Sidoqoftë ueb faqja e OSHP në përgjithësi i plotëson standardet minimale të transparencës dhe siguron një numër të madh të informatave të cilat ndihmojnë të gjitha palët e interesuara në punën e OSHP.

15 Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

Ekspertizat

Shqyrtimi i secilës lëndë që plotëson kushtet për t'u pranuar në OSHP përfshinë të paktën një ekspertizë e cila supozohet t'i ndihmojë panelin shqyrtues në marrjen e vendimit. Përkundër faktit që paneli shqyrtues rezervon të drejtën që të vendosë në kundërshtim me rekomandimin e ekspertit, në të shumtën e rasteve këto ekspertiza paraqesin boshtin e vendimit të panelit shqyrtues.

Ekspertët shqyrtues


Për këtë qëllim OSHP angazhon dy lloje kryesore të ekspertëve për të ndihmuar ata në marrjen e vendimeve sa më të informuara. Lloji i parë i ekspertëve përfshinë ekspertët shqyrtues të cilët janë punonjës të OSHP-së me orar të plotë. Të tillë aktualisht OSHP ka të angazhuar tre persona: Visar Basha; Visar Bibaj; si dhe Basri Fazliu. Për shkak të numrit të vogël të ekspertëve dhe numrit të madh të lëndëve, edhe zyrtarët e tjerë të OSHP-së shfrytëzohen për të ndihmuar panelet me ekspertiza në këto lëndë. Gjatë vitit 2016, për këtë qëllim janë angazhuar edhe: Erleta Popaj, Safije Bullatovci, Burim Guri dhe Zeqir Fetoshi.

Mandatin për të përzgjedhur ekspertin për lëndën përkatëse e ka kryesuesi i sekretariatit të OSHP. Nuk ka rregulla të shkruara të cilat përcaktojnë formën dhe radhën e ndarjes së lëndëve për të shmangur lidhjen e ekspertit shqyrtues me operatorin ekonomik apo autoritetin kontraktues. Kjo mund të rrezikoj që ekspertët të caktohen personat e njëjtë për një institucion të caktuar dhe të ndërtojnë lidhje personale të cilat mund të ndikojnë vendimmarrjen. Në kuadër të vlerësimit të rrezikut për OSHP kjo mund të jetë një nga çështjet më të ndjeshme. Ky është një pushtet shumë i madh në kuadër të kompetencave diskrecionale të kryesuesit të sekretariatit dhe një gjë e tillë duhet të adresohet nga bordi i OSHP-së. Forma më e mirë e caktimit të lëndëve në rrethanat aktuale do të ishte rotacioni. Në këtë formë edhe shpërndarja e rasteve do të ishte e barabartë, edhe palët do të caktoheshin rastësisht gjë e cila do të minimizonte përshtatjen e ekspertëve me autoritetet kontraktuese apo operatorët ekonomik. Ekspertët shqyrtues janë ekspert të përgjithshëm të cilët nuk shquhen për njohje specifike në fusha të caktuara. Përkundrazi ekspertët shqyrtues janë njohës të procedurave dhe hulumtues të cilët duhet të japin përgjigje për pretendimet ankimore të bizneseve. Prandaj, në rastin e ekspertëve shqyrtues të OSHP, nuk ka asnjë arsye që të mos caktohen në formë të rotacionit.

Në lidhje me këtë vërejtje është përgjigjur "Sipas nenit 19 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së OSHP nr. 02/2015, nëse pas pranimit të një ankesë konstatohet se e

njëta i takon juridiksionit të OSHP-së për shqyrtim, atëherë është në kompetencë të Kryesuesit të OSHP-së që të caktojë një ekspert për shqyrtim. Po ashtu, çështja e caktimit të ekspertit për lëndë, është bërë sipas paragrafit 11 të nenit 19 të rregullores së lartpërmendur, dhe se e gjithë procedura e caktimit të ekspertëve shqyrtues bëhet konform rregullores së punës së OSHP-së dhe ngarkesave që ata kanë në punë, gjithmonë duke pasur parasysh numrin e vogël të ekspertëve të brendshëm shqyrtues në OSHP¹⁶.

EKSPERTËT SHQYRTUES



Ekspertët e jashtëm (teknik)

Në kuadër të shqyrtimit të rasteve të ankesave në mes të operatorëve ekonomik dhe autoriteteve kontraktuese, sidomos në çështjet e kritereve të përdorura nga këto të fundit për plotësimin e kushteve teknike, janë të nevojshme ekspertizat profesionale. Për këtë qëllim OSHP ka krijuar një grup të ekspertëve teknik nga fusha të ndryshme të cilët do të ndihmojnë panelet shqyrtuese në çështjet të cilat

¹⁶ Komentet e OSHP të datës 20 prill 2017 në lidhje me të gjeturat e raportit të monitorimit.

janë profesionale dhe me specifikime teknike. Lista e OSHP përmban 47 ekspertë të cilët janë pranuar përmes një konkursi të hapur me datën 26 shtator 2016. Angazhimi i secilit ekspert teknik bëhet nga kryetari i OSHP-së për dallim nga ata shqyrtues të cilët angazhohen nga kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së.

Fushat e ekspertëve teknik të OSHP janë si në vijim:

- Fakulteti Ekonomik – 3 ekspertë
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – 13 ekspertë
- Fakulteti i Inxhinierisë – 8 ekspertë
- Fakulteti i Makinerisë – 3 ekspertë
- Fakulteti i Mjekësisë – Farmaci 4 ekspertë
- Shkenca Kompjuterike – 2 ekspertë
- Matematikë-Kimi – 5 ekspertë
- Gjeodezi – 1 ekspertë
- Veterinari/Bujqësi – 2 ekspertë
- Xehtari Metalurgji – 1 ekspertë
- Të tjera


Problematike në këtë kuptim mbetet angazhimi i ekspertëve për fusha të cilat nuk ka kontraktuar OSHP asnjë ekspert. Kjo listë në maksimum në këtë formë mund të azhurnohet një herë në vit dhe kjo nuk siguron listë gjithëpërfshirëse për nevojat e OSHP. Në fakt, numri më i madh i ekspertëve të pranuar nga OSHP, të cilët janë përfshirë në listë nuk janë angazhuar fare. Pjesa tjetër kanë pasur një numër minimal të angazhimit.

Në vitin 2016, 30 nga 47 ekspertët e pranuar nuk janë angazhuar nga ana e OSHP-së as edhe për një rast të vetëm. Me nga një lëndë janë angazhuar tetë ekspertë të jashtëm, përderisa ekspertët më së shpeshti të angazhuar janë: Muhamet Kurtishaj me 30 lëndë, Qazim Hoxha me 22 dhe Zenel Hisenaj me 9 raste.

Nga shpërndarja e rasteve vërehet se OSHP nuk ka përdorur asnjë mekanizëm të vlerësimit të performancës dhe dhënies së rastit të secilit ekspert të pranuar për të dëshmuar shkathtësitë e tyre. Shikuar nga këndi i parandalimit të korrupsionit, lidhjet në mes të ekspertëve dhe anëtarëve të panelit mund të konsiderohen një nga dimensionet e rritjes së rrezikut. Bordi i OSHP duhet të sigurojë që këta ekspertë të kenë matje të performancës, ekspertizat t'u ndahen në fushat e përgatitjes së tyre përkatëse dhe shpërndarja të jetë më e drejtë për ekspertët e jashtëm.

Nga shqyrtimi i të dhënave është vërejtur se një numër i ekspertëve teknik nga ana e OSHP-së janë mandatuar me kompetencën e ekspertit shqyrtues. Këto dy role të ekspertëve dallojnë në mënyrë substanciale dhe e njëjta përzierje është e palejuar me rregulloret e OSHP në fuqi në kohën kur kanë ndodhur këto ekspertiza.

EKSPERTËT TEKNIK



■ Ekspertiza ■ Të aprovuara ■ Të refuzuara

Operatorët ekonomik

Në vitin 2016, shumë operatorë ekonomik kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës më shumë sesa një herë për t'u ankuar kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese. Për qëllimet e këtij raporti janë nxjerrë të dhënat e pesë prej kompanive të cilat kanë parashtruar numrin më të madh të ankesave dhe është vlerësuar efikasiteti i këtyre ankesave dhe trajtimi në OSHP.

Vendime në favor të OE	Vendime kundër OE	Totali i ankesave
6	4	10

PBC SHPK

Nr.	AK	Eksperti	Ekspertiza në favor të OE	Vendimi në favor të OE
1	Komuna e Gjakovës	Basri Fazliu	Jo	Jo
2	Komuna e Prizrenit	Safije Saramati dhe Mimoza Avdimetaj	Jo	Jo
3	Komuna e Prishtinës	Visar Bibaj dhe Zenel Hisenaj	Po	Po
4	Komuna e Gjakovës	Basri Fazliu dhe Zenel Hisenaj	Jo	Jo
5	Qendra e Studentëve	Shqipe Hoti dhe Zenel Hisenaj	Jo	Jo
6	Qendra e Stacioni i autobusave - Prishtinë	Basri Fazliu dhe Zenel Hisenaj	Po	Po
7	Ministria e Infrastrukturës	Visar Bibaj dhe Driton Thaçi	Po	Po
8	Komuna e Prishtinës	Visar Bibaj dhe Sami Shatri	Po	Po
9	Univerersiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	Visar Bibaj	Po	Po
10	Komuna e Ferizajit	Basri Fazliu dhe Labinot Hasanaj	Po	Po

Vendime në favor të OE	Vendime kundër OE	Totali i ankesave
1	3	4

Ndërtimi SHPK

Nr.	AK	Eksperti	Ekspertiza në favor të OE	Vendimi në favor të OE
1	Ministria e Infrastrukturës	Visar Bibaj	Po	Jo
2	Komuna e Obiliqit	Sabrije Bullatovci	Po	Jo
3	Komuna e Pejës	Visar Bibaj	Po	Po
4	Ministria e Infrastrukturës	Visar Bibaj	Po	Jo

Vendime në favor të OE	Vendime kundër OE	Ankesa
2	1	3

Security Code

Nr.	AK	Eksperti	Ekspertiza në favor të OE	Vendimi në favor të OE
1	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Qazim Hoxha	Po	Po
2	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Qazim Hoxha	Po	Po
3	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Qazim Hoxha	Po	Jo

Vendime në favor të OE	Vendime kundër OE	Ankesa
2	1	3

Laguna SHPK

Nr.	AK	Eksperti	Ekspertiza në favor të OE	Vendimi në favor të OE
1	Zyra e Rregullatorit për Energji	Sabrije Bullatovci	Po	Po
2	Agjencia Qëndrore e Prokurimit Publik	Muhamet Kurtishaj	Po	Po
3	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	Qazim Hoxha	Jo	Jo

Vendime në favor të OE	Vendime kundër OE	Ankesa
2	1	3

Botek SHPK

Nr.	AK	Eksperti	Ekspertiza në favor të OE	Vendimi në favor të OE
1	Ministria e Infrastrukturës	Visar Bibaj	Po	Po
2	Univeriteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	-	-	Jo
3	Ministria e Infrastrukturës	Visar Bibaj	Po	Po

Autoritetet kontraktuese

Numri i ankesave për secilin autoritet kontraktues është një nga indikatorët se si janë menaxhuar aktivitetet e prokurimit. Përkundër që numri i ankesave nuk mund të konsiderohet si forma e vetme e matjes së performancës, përsëri është një indikator i mirë për formën se si ka prokuruar një institucion. Në këtë kuadër disa institucione veçanërisht janë shquar për një numër të madh të ankesave. Pesë autoritetet kontraktuese me numrin më të madh të ankesave gjatë vitit 2016 janë:

1. Korporata Energjetike e Kosovës 44
2. Ministria e Infrastrukturës 25
3. Komuna e Prishtinës 22
4. Komuna e Pejës 18
5. Policia e Kosovës 18

Në anën tjetër, nëse krahasohen aktivitetet e prokurimit me numrin e ankesave dhe përqindjen e tenderëve të kontestuar, pesë autoritetet kontraktuese me përqindjen më të lartë të ankesave janë:

Institucioni	Nr. i Tenderëve	Nr. i Ankesave	Përqindja Tender/Ankesa
Agjencia Qendrore e Prokurimi	11	9	81%
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve e Memoriale	11	4	36%
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	16	5	31%
Ministria e Infrastrukturës	81	25	30%
Zyra e Rregullatorit për Energji	4	1	25%

Shkeljet e evidentuara në autoritetet kontraktuese

Për shkak të mandatit të OSHP të gjitha ankesat që vijnë në këtë institucion kanë të bëjnë me çështjet e kriterëve të tenderit, vlerësimin e ofertave apo kërkesat për të futur në listë të zezë operatorë të cilët kanë kryer shkelje të rënda të Ligjit. Sidoqoftë, një numër i shkeljeve janë më të shpeshta dhe brenda kësaj periudhe raportuese kanë tërhequr vëmendjen.

- 1. Çmimet jo normalisht të ulëta.** Në shumicën e ankesave të shqyrtuara nga OSHP ndër të tjera si arsye për ankesë janë përmendur edhe çmimet jo normalisht të ulëta me të cilat operatorët aplikojnë në një numër të njëjësive të cilat kërkohen me dosjen e tenderit. Sidoqoftë, OSHP dhe Ligji i Prokurimit Publik ende nuk i kanë dhënë një përgjigje apo formulë të kalkulimit të qartë se çka do të konsiderohet çmim jo normalisht i ulët. Nuk ka asnjë dyshim se pjesën më të madhe të fajit për tolerimin e fenomenit të çmimeve jo normalisht të ulëta e bartin vet autoritetet kontraktuese të cilat nuk kërkojnë zbatim të plotë të kontratave. Në rastet kur operatorët do të refuzonin këtë gjë, atëherë do të mund të ndërpritej kontrata. Mirëpo, në mungesë së përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese, apo disa prej tyre, OSHP duhet që të zhvillojë metodologjinë e saj, se si do të trajtoj çmimet jo normalisht të ulëta dhe sa diskrecion do t'i lihet autoriteteve për ta vendosur këtë. Deri më tani, këto çmime jo normalisht të ulëta janë vërejtur ndër të tjera në kontratat e pastrimit të objekteve, shërbimeve hoteliere dhe kontratave të sigurimeve të objekteve dhe ato të automjeteve. Në mungesë të metodologjisë konkrete për këtë çështje, OSHP ka marr vendime duke i shqyrtuar faktet e secilit rast veç e veç dhe duke vendosur mbi meritën e secilit rast, duke mos synuar të krijoj standard unik dhe konsistencë në vendimmarrje.
- 2. Tërheqja e autorizimeve apo nën-kontraktorëve.** Në disa raste është vërejtur se arsyet që kanë qar në eliminimin nga gara për tender ka qenë faza kur autoritetet kontraktuese kanë kontrolluar nëse operatorët me të vërtetë kanë autorizime për të ofertuar. Kjo u ka shërbyer kompanive që kanë lëshuar autorizime që të shohin interesin e tyre dhe nëse operatori i radhës për të fituar kontratën gjithashtu ka qenë i autorizuari i tyre, ato kanë tërhequr autorizimet e tyre. Kjo ka ndodhur brenda kësaj periudhe raportuese të paktën në tre raste. Në këtë çështje janë përfshirë në konteste [Reforma v. Policia e Kosovës](#), 429/16. PBC v. Ministria e Administratës Publike dhe [El-Bau v. Komuna e Vitisë](#), 26/17.
- 3. Kërkesa për informacione shtesë.** Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik autoritetet kontraktuese para se te vendosin mbi fatin e një oferte, kanë të

drejtë të kërkojnë sqarime shtesë nga operatori. Kjo kërkesë nuk nënkupton që operatori mund të ndryshoj kushtet e tenderit apo të ndryshoj përmbajtjen e ofertës së tij. Sidoqoftë, aty mund të sqarohen nëse është plotësuar ndonjë kusht për të cilin komisioni i vlerësimit të ofertave nuk është i sigurt apo nëse për ndonjë çështje komisioni ka nevojë të marr më shumë informata para se të rekomandojë për dhënien e kontratës. Kjo çështje është lënë në diskrecionin e autoriteteve kontraktuese, në atë mënyrë që ato vetë të vendosin nëse do të kërkojnë informata shtesë apo vetëm do të eliminojnë ofertat e caktuara.

4. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit për mungesë të mjeteve financiare.

Një numër i autoriteteve kontraktuese, pasi që të kenë shpall procedurat e prokurimit, në faza të ndryshme, madje edhe pasi të ketë përfunduar vlerësimi i ofertave vendosin të anulojnë procedurën me arsyetimin se nuk kanë mjetë të mjaftueshme në dispozicion. Kjo në shumë raste lë të kuptohet se bëhet me qëllim që të mos përzgjidhet kompania e cila ka pasur kushtet më të mira dhe ka pasur gjasat më të mëdha për të fituar tenderin. Në çështje të tilla, po ashtu, OSHP nuk ka krijuar një rregull strikt i cili do t'u pamundësonte autoriteteve kontraktuese të luajnë me këtë të drejtë si mjet i fundit për të eliminuar kompanitë të cilat ata nuk i dëshirojnë si fituese. Në disa raste kjo praktikë nuk është lejuar dhe autoriteteve u është kërkuar të anulojnë vendimin për anulim dhe të vazhdojnë me lidhjen e kontratës rasti *MedicalGroup, EuroLab v. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës*, 450-51/16. në raste të tjera kjo është toleruar, *Ekoinvest v. Korporata Energjetike e Kosovës*, 481/16. *Blendi v. Komuna e Prishtinës*, 447/16. Në çështjet e anulimit të tenderëve pasi të jenë hapur ofertat dhe të jetë bërë deklarata e disponueshmërisë së mjeteve, po ashtu, OSHP nuk ka krijuar konsistencë të vendimmarrjes. Kjo mund të jetë bërë për shkak të strukturës së fakteve që kanë mundur të bëjnë deri diku të ndryshme këto raste. Sidoqoftë, OSHP do të duhej të krijonte rregulla të tilla me të cilat i jepet përgjigje të gjitha autoriteteve kontraktuese nëse mund dhe për çfarë arsye mund të anulohen aktivitetet e prokurimit.

Institucionet më problematike

Varësisht nga buxheti dhe numri i aktiviteteve të prokurimit disa institucione janë shquar për më pak e disa për më shumë ankesa për aktivitetet e tyre të prokurimit. Sidoqoftë, në këtë tre mujor të monitorimit të OSHP, numri më i madh i ankesave dhe lëndëve është vërejtur në këto institucione:

- 1. Korporata Energjetike e Kosovës.** Ky institucion brenda tre mujorit të monitoruar ka pasur 20 lëndë në shqyrtim. Nga këto lëndë 14 janë vendosur në favor të saj, ndërsa gjashtë janë vendosur në favor të operatorëve ekonomik ankues. Në panel shqyrtues KEK ka pasur Blerim Dinën 11 raste, Goran Milenkovic gjashtë raste, Ekrem Salihu tetë raste, Nuhi Paçarizi 15 raste, Tefik Sylejmani 14 raste. Në anën tjetër ekspertët e angazhuar, ishin Muhamet Kurtishaj me dy raste, Visar Bibaj dy raste, Burim Guri dy raste, Sabrije Bullatovci dy raste, Albulena Shabani dy raste, Halil Hoti dy raste, Zivce Sarkocevic një, Halil Hoti një dhe Basri Fazliu një. Ankesat për KEK nga ana e operatorëve ekonomik kanë qenë të rënda, që nga përshtatja e kriteve, trajtimi i anshëm i ofertave e deri tek pengimi i qasjes në dokumente zyrtare dhe anulimi i aktiviteteve të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme. Në dy raste OSHP ka ngritur edhe dyshime për korrupsion dhe favorizim të kompanive. Në këtë rast “Furnizim me gëlqere të hidratizuar” *Diari v. Korporata Energjetike e Kosovës*, 404/16. OSHP ka kërkuar hetim të rastit pasi që përkundër kërkesës së OSHP-së për të verifikuar Certifikatën ISO të Operatorit, KEK nuk e ka bërë. Rast tjetër në të cilin ka pasur akuzë për lajthitje të institucionit është *FörderanlagenMagdeburg, Ekoinvest v. Korporata Energjetike e Kosovës*, 29/17. Eksperti shqyrtues në këtë rast është ankuar se KEK e ka vënë në lajthitje dhe është tërhequr nga rekomandimi i ekspertizës. Nga vlerësimi i të gjitha lëndëve të shqyrtuara në OSHP, del se KEK është institucioni me numrin më të madh të ankesave dhe rrjedhimisht shkeljeve të kryera. Për shkak të natyrës shumë specifike të tenderëve të KEK, ky institucion shpesh herë arrin që të fshihet prapa kërkesave specifike për shkak të specifikave dhe nevojave industriale. Megjithatë, një gjë është e sigurt që tenderët e KEK-ut për shkak të natyrës specifike dhe vlerës shumë të lartë të kontratave duhet të trajtohen veçanërisht dhe me ekspertiza më profesionale teknike. Kjo për arsye se vetëm njohja e Ligjit të Prokurimit Publik, pa i ditur mirë nevojat dhe arsyeshmërinë specifike të tenderëve nuk mund të merren vendime të duhura. Në anën tjetër pakënaqësitë e operatorëve me këtë institucion janë shumë të mëdha.
- 2. Qendra Klinike Universitare e Kosovës.** Brenda këtij tre mujori, janë shqyrtuar ankesat e gjashtë operatorëve ekonomik kundër vendimeve të këtij institucioni. Të gjitha seancat për QKUK-në janë mbajtur të hapura. Nga gjashtë ankesat e

operatorëve, QKUK ka fituar tri raste, përderisa ka humbur tri të tjera. Dallim i madh mund të vërehet në mes të ekspertizave dhe vendimeve të panelit. Kjo për shkak se nga gjashtë ankesa, ekspertët kanë rekomanduar aprovimin e të gjashtë ankesave. Paneli shqyrtues ka marr vendim të kundërt në tre raste. Ankesat në të cilat janë marr vendime të kundërta me rekomandimet e ekspertëve janë “Pastrimi i hapësirave të brendshme të QKUK-së”, *Krasniqi, Beni, Shfenberg v. Qendra Klinike Universitare e Kosovës*, 436/16. Ekspertiza e Qazim Hoxhës është injoruar nga paneli dhe është marr vendim i kundërt në favor të Autoritetit Kontraktues. Rasti tjetër në të cilën nuk është marr parasysh rekomandimi i ekspertëve Safije Saramati dhe Fellenza Abazi ka të bëjë me tenderin “Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur”. Për më tepër kjo seancë edhe pse formalisht e hapur nuk ka qenë e paralajmëruar në ueb faqe. *Koslabor v. Qendra Klinike Universitare e Kosovës*, 08/17. Rasti i fundit në të cilin paneli ka vendosur në kundërshtim me ekspertizën është *LediMed v. Qendra Klinike Universitare e Kosovës*, 430/16. Ekspertiza e Visar Bibajt dhe Shefqet Emërllahut është refuzuar nga paneli, duke vendosur në kundërshtim me rekomandimin e ekspertëve Ekspertizat për ankesat kundër QKUK-së janë bërë nga Visar Bibaj 4 raste, Safije Saramati 1, Qazim Hoxha 1, Fellenza Abazi 1, Osman Hoti 2, Shefqet Emërllahu 1. Paneli që ka gjykuar rastet përfshinë: Blerim Dina 6 raste, Goran Milenkovic 5 raste, Nuhi Paçarizi 6 raste, Tefik Sylejmani 5 raste, Ekrem Salihu 4 raste.

- 3. Policia e Kosovës.** Në këtë periudhë raportuese kundër aktiviteteve të prokurimit të Policisë së Kosovës janë dorëzuar 7 ankesa dhe 3 kërkesa të Policisë për të futur kompani në *listë të zezë*. Nga këto raste ankesa të shqyrtuara në seanca të hapura janë pesë, kurse në seanca të mbyllura janë pesë, duke përfshirë edhe dy kërkesa për futjen në listë të zezë të operatorëve ekonomik. Pesë vendime janë në favor të operatorëve ekonomik, duke përfshirë edhe dy kërkesa për të përfshirë në listë të zezë kompanitë, përderisa në favor të Policisë së Kosovës janë vendosur pesë raste të tjera, duke përfshirë një kërkesë për futje të operatorit *5 Vëllezërit Mulaku në Listën e Zezë*. Ekspertët të cilët kanë trajtuar lëndët e Policisë së Kosovës janë: Visar Basha, Basri Fazliu tri raste, Visar Bibaj, Muhamet Kurtishaj, Shqipe Hoti dhe Qazim Hoxha. Anëtarët e panelit të cilët kanë gjykuar rastet e Policisë janë: Blerim Dina 4 raste, Nuhi Paçarizi 5, Goran Milenkovic 4, Tefik Sylejmani 5, dhe Ekrem Salihu 4 raste.
- 4. Komuna e Prishtinës.** Ka pasur shtatë ankesa nga të cilat pesë janë shqyrtuar në seanca të hapura, ndërsa dy të tjera në seancë të mbyllur. Gjashtë raste kanë qenë në favor të Komunës së Prishtinës dhe vetëm një është fituar nga operatori ekonomik PBC. Paneli në dy raste ka refuzuar rekomandimet e ekspertëve për të vendosur në favor të operatorëve ekonomik. Rasti i parë është *Sendertimi v. Komuna e Prishtinës*, 363/16. Rekomandimi i ekspertës Sabrije Bullatovci që të aprovohet ankesa e operatorit ekonomik nuk është marr parasysh. Rast tjetër

ku është refuzuar ankesa e operatorit ekonomik së bashku me rekomandimin e ekspertit për ta aprovuar atë është *Sigkos v. Komuna e Prishtinës*, 470/16. Në këtë rast është refuzuar rekomandimi i ekspertit Burim Guri. Ekspertizat në lëndët e Komunës së Prishtinës janë bërë nga Sabrije Bullatovci 2, Visar Bibaj 1, Zenel Hisenaj 1, Basri Fazliu 1, Burim Guri 1, Visar Basha 1 dhe Muhamet Kurtishaj 1.

- 5. Agjencia Qendrore e Prokurimit.** Gjatë kësaj periudhe tre mujore, në OSHP kanë parashtruar ankesë 4 operator ekonomik kundrejt vendimeve të AQP-së. Prej këtyre ankesave, njëra ka të bëjë me "Furnizim me karburante", ku Operatori Ekonomik HIB Petrol është drejtuar në OSHP, duke u ftuar më pas të marr pjesë edhe në seancën e hapur të mbajtur më datë 16/02/2017. Ndonëse ekspertiza e Sabrije Bullatovci ishte në favor të AQP-së, paneli shqyrtues ka vendosur në favor të Operatorit Ekonomik. Sa i përket 3 ankesave të tjera, ato kanë të bëjnë me "Shërbime të Pastrimit – Kontratë Kornizë" të ndarë në lotet 1, 5, 7, 8, 9 dhe 10. Ashtu si në rastin paraprak, ekspertiza ka qenë në favor të Autoritetit Kontraktues, mirëpo vendimi është marr në favor të Operatorëve Ekonomik, e që në këtë rast janë: Oni Impex, Uni Project dhe MSS Mobile Sanitary Service. Në përgjithësi, të gjitha seancat e mbajtura për shqyrtimin e ankesave ndaj AQP-së kanë qenë të hapura. Gjatë trajtimit të lëndëve, në rastin e parë paneli shqyrtues mori pjesë me 3 anëtarët e tij: Blerim Dina, Nuhi Paqarizi, Goran Milenkovic, kurse në rastin e dytë ishte prezent i gjithë paneli me 5 anëtarët.
- 6. Ministria e Administratës Publike.** Kundër aktivitetve të prokurimit të këtij institucioni ka pasur katër ankesa nga katër operatorë të ndryshëm ekonomik. Në lidhje me aktivitetin për "Shërbime – Telefonike Mobile, Internet, Internet GPRS, Kabllo Optike, Shërbime të Telefonisë dhe Shërbime të TV Kabllor", Operatori Ekonomik "IPKO" iu drejtua OSHP-së duke shprehur pretendimet e veta ankimore kundër vendimit për dhënie të tenderit pa procedurë të hapur për Telekomin e Kosovës. Edhe pse eksperti i kësaj lënde, Qazim Hoxha në raportin e tij kishte rekomanduar të aprovohej ankesa e Operatorit Ekonomik Ankues, Paneli Shqyrtues vendosi në kundërshtim me ekspertizën. Gjithashtu, Operatori Ekonomik "Uni Project" shprehi pakënaqësitë e veta për vendimin e MAP-së në lidhje me aktivitetin për "Mirëmbajtje teknike të ndërtesave qeveritare". Ankesa e këtij Operatori Ekonomik u aprovua nga Paneli Shqyrtues, edhe pse ekspertiza e Visar Basha ishte në favor të Autoriteti Kontraktues. Ndërsa, 2 seancat tjera të mbajtura pa praninë e palëve, ajo për "Furnizim me inventar" ndaj të cilës u ankua Kompania "Graniti", dhe ajo e "Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare dhe kompleksin e pallatit të drejtësisë" ndaj të cilës u ankua Kompania "Stewart Inspect Kosova", u morr vendim në favor të operatorëve ekonomik, ashtu siç u rekomandua edhe nga Ekspertët Shqyrtues.

Lista e zezë


Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur katër kërkesa për të futur kompani në listë të zezë. Nga këto kërkesa tri janë bërë nga Policia e Kosovës, përderisa një nga KEK. E suksesshme në anën tjetër ka qenë vetëm një kërkesë e Policisë së Kosovës, për të futur në listë të zezë kompaninë 5 Vëllezërit Mulaku. Kërkesat e tjera nuk janë aprovuar, për mungesë të arsyeve dhe provave bindëse se të njëjtat meritojnë të futën në këtë listë. Më shqetësuese ka qenë kërkesa e Policisë së Kosovës e cila e ka akuzuar për falsifikim kompaninë Kapital X, mirëpo nuk ka sjellë asnjë provë të organeve të saja se dokumenti është falsifikuar, vetëm ka thënë se numrat nuk i përputhen me dokumentet e Administratës Tatimore të Kosovës. Kjo është rrëzuar lehtësisht me një arsyetim të ATK se ka pasur një gabim nga ana e tyre në sistem prandaj ka ndodhur mos përputhja e numrave të kompanisë.

AUTORITETI KONTRAKTUES	OPERATORI EKONOMIK	PANELI	VENDIMI
POLICIA E KOSOVËS	Kapital X	Ekrem Salihu, Blerim Dina, Tefik Sylejmani	Refuzuar
	5 Vëllezërit Mulaku	Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi, Goran Milenković	Aprovuar
	Euro Construction	Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi, Goran Milenković	Refuzuar
KEK	Solid Company	Blerim Dina, Nuhi Paçarizi, Ekrem Salihu	Refuzuar

Niveli i angazhimit të anëtarëve të OSHP

Si institucion i pavarur, OSHP përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, të cilët shërbejnë si “gjyqtarë” të ankesave të operatorëve ekonomik. Sidoqoftë, nuk ka një mënyrë të drejtë të ndarjes së lëndëve për këta anëtarë në Ligj apo Rregullore të punës. Për këtë arsye nuk mund të shmangen rastet që një anëtarë të mos krijoj lidhje me operatorët apo autoritetet. Po ashtu, ndarja e drejtë e punëve nuk është siguruar në këtë aspekt. Anëtari më së paku i angazhuar në 2016 është Goran Milenkovic, kurse ai më i angazhuar është Tefik Sylejmani.

ANGAZHIM I ANËTARËVE TË OSHP



Rekomandimet

1. Bordi i OSHP-së të hap për publikun të gjitha seanca në të cilat shqyrtohen ankesat e operatorëve ekonomik, pavarësisht nëse ato mbahen me apo pa prezencën e palëve. Ky veprim do të rris transparencën dhe besimin e publikut në vendimet e Institucionit.
2. OSHP të hartojë udhëzues apo rregullore për rregullat e përfaqësimit të palëve në seancat e OSHP-së. Rregullorja do të përcaktonte rregullat që sigurojnë barazinë në trajtim të palëve në seancat dëgjimore. Në këtë dokument ndër të tjera do të përcaktoheshin se sa kohë kanë palët në dispozicion për të prezantuar pretendimet e tyre, cilat janë ndalesat dhe kur ato mund të largohen nga salla apo të dënohen për shkak të thyerjes së rregullave.
3. Përcaktimi i ekspertëve shqyrtues sipas një software apo ndonjë rregulle që siguron pa-anshmëri dhe ndarje të barabartë të numrit të lëndëve . Gjithashtu kërkohet matje e performancës dhe konsistencës në dhënien e rekomandimeve të ekspertët. Kjo do të ndihmonte OSHP-në të mund të marr masa në përputhje me suksesin që kanë treguar ekspertët apo në rast të performancës së dobët të merren masat e duhura.
4. Vendimet të cilat merren nga paneli në përputhje me kërkesat ligjore të publikohen më së largu pesë ditë pasi që të jetë marrë vendimi. Çdo vonesë në publikimin e këtyre vendimeve shton dyshimet dhe ngre pyetjen se për çfarë arsye disa vendime publikohen në afate rekorde pa asnjë vonesë ndërsa të tjera presin me dhjetëra ditë, ndonjëherë edhe me muaj.
5. OSHP të bëjë angazhim më të barabartë të ekspertëve të jashtëm teknik nga lista e ekspertëve për të siguruar se mbi angazhimi nuk bëhet në suaza të favorizimeve për individë të caktuar. Po ashtu duhet të ketë matje të performancës së këtyre ekspertëve për të arsyetuar qëndrimin e tyre në listë të ekspertëve. Për më tepër lista e ekspertëve do të duhej të ishte e hapur për të gjithë personat që plotësojnë kushtet dhe kërkesat sipas nevojave të OSHP gjatë gjithë vitit. OSHP do të ishte mirë t'i lejonte vetës që në kuadër të nevojave specifike të identifikojë dhe angazhojë ekspert të jashtëm të cilët nuk janë pjesë e listës, mirëpo të cilët do të mund të kishin eksperiencë dhe ekspertizë të vlefshme për këtë institucion.
6. Të bëhet matja e konsistencës së vendimeve të OSHP-së për të siguruar që OSHP vendosë në mënyrë të pa-anshme dhe meritore për të gjitha palët dhe

në të gjitha rastet. Kjo do t'i siguronte Bordit të OSHP-së një mundësi për të vendosur disa standarde mbi trajtimin e ankesave, do të rriste besimin e palëve në këtë institucion si dhe do të bënte më të pritshme rezultate e ankesave për raste të ngjashme ose të njëjta.

7. OSHP të publikojë të gjitha ekspertizat duke përfshirë edhe ato teknike, së bashku me arsyetimet e ekspertëve mbi rekomandimet të cilat kanë ofruar. Kjo do të ndihmonte publikun që të kuptonte më tepër mbi ankesat dhe vendimet e marra nga OSHP.
8. Të ndërmerren masa kundër operatorëve të cilët paraqesin ankesa qartësisht të pa bazuara në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të cilat qëllim të vetëm kanë vonesën e procedurës.
9. Të krijohen teste për të analizuar në formë të unifikuar mosmarrëveshjet të cilat janë të përsëritshme. Për shembull, në rastet e çmimeve jo normalisht të ulëta apo të larta, OSHP do të mund të krijonte testin standard për të parë se deri në çfarë mase çmimet jo normalisht të ulëta apo të kombinuara me çmime jo normalisht të larta do të toleroheshin. Kjo do të ndihmonte edhe vet autoritet kontraktuese në vlerësimin e ofertave.
10. OSHP të ftoj dëshmitarë për të dëshmuar në rastet të cilat janë në shqyrtim atëherë kur është e nevojshme e veçanërisht kur për të njëjtin person palët sjellin deklarime nëpërmjet emailave të cilat janë kundërthënëse. Dëshmitarët po ashtu është mirë që të përballen me pyetjet e panelit dhe palëve në kontest.
11. Të publikohen votat e anëtarëve të panelit në lidhje me vendimet e OSHP-së për të gjitha lëndët. Ngjashëm me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të cilët nuk pajtohen me vendimin duhet t'i ofrohet mundësia që në vendim të ketë opinionin e tyre, në lidhje me mos pajtueshmërinë e tyre me vendimin e anëtarëve të panelit.
12. Të publikohen të plota dhe me të paktën pesë ditë kalendarike më herët seancat e OSHP-së për trajtim të ankesave. Po ashtu, të publikohen të plota ankesat në ueb faqe dhe të ri-organizohen për të lehtësuar kërkimet e lëndëve në bazë të filterëve të ndryshëm, sipas praktikave të mira të institucioneve të tjera në Kosovë (shembull Gjykata Kushtetuese).

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

347.7(496.51)

(Pa) drejtësia në prokurim : raporti i monitorimit tre mujorit të organit shqyrtues të prokurimit : dhjetor 2016-shkurt 2017 / raporti i përgatitur nga Isuf Zejna dhe Sara Zhubi. – Prishtinë : Democracy Plus, 2017. – 34 f. : ilustr. ; 24 cm.

1.Zejna, Isuf 2. Zhubi, Sara

ISBN 978-9951-8943-2-6

Për Demokraci Plus

Demokrasi Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jo-fitim prurëse e themeluar nga një grup aktivistësh që besojnë fuqishëm në vlera demokratike dhe në shoqëri kosovare me demokraci të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që ndërtojnë një shoqëri aktive. Tri programet kryesore të D+ janë Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, Partitë Politike dhe Zgjedhjet, si dhe Çështjet Sociale dhe të Drejtat e Njeriut.

Përkrahur nga:

ISBN 978-9951-8943-2-6

